

**KOMUNA E KLINËS**  
**Kuvendi Komunal**

**RREGULLORE KOMUNALE**  
**PËR VEPRIMTARITË KOMUNALE**

**Klinë , tetor 2001**

Në mbështetje të nenit 4 të Rregullores nr. 2000/ 45, mbi Vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës, nenit 1 të Rregullores 1999/ 24 , të ligjeve në fuqi në Kosovë, të Ligjit mbi Veprimtaritë Komunale ( Gaz. Zyr. e Kosovës, nr. 30 / 87 dhe 40 / 82 ) dhe nenit 92, të Statutit të Komunës së Klinës, Kuvendi Komunal në mbledhjen e vet të mbajtur, më datën 10.10. 2001, aprovoi këtë:

## **RREGULLORE KOMUNALE**

### **PËR VEPRIMTARITË KOMUNALE**

#### **I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

##### Neni 1.

Me këtë Rregullore përcaktohen kushtet e përgjithshme për kryerjen e veprimtarive komunale, kushtet për rregullimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve të ujësjellësit, mirëmbajtja e brigjeve dhe shtretërve të lumenjve, kanalizimit, si dhe të pastërtisë – higjienës publike në territorin e komunës të Klinës, përcaktohen detyrat e Komunës, ndërmarrjes për kryerjen e shërbimeve publike për tërë territorin e komunës së Klinës, qytetarëve, si dhe të gjithë pjesëmarrësve tjerë (ndërmarrjeve private, shoqërore dhe shtetërore etj. ), si dhe kushtet minimale për mbajtjen e pastërtisë dhe higjienës në fshatra.

##### Neni 2.

Mbajtja e pastërtisë konform dispozitave të kësaj Rregulloreje nënkupton pastrimin dhe larjen e sipërfaqeve publike me qëllim të largimit të të gjitha llojeve të mbeturinave, borës, pastrimi i oborreve, largimi i hedhurinave dhe mbeturinave, fekaleve, ujërave të ndotura, gropave septike, si dhe mbeturinave të tjera.

Rregullimi i vendbanimit, konform dispozitave të kësaj Rregulloreje nënkupton: rregullimi i rrugëve, tregjeve, trotuareve, ndriçimit publik dhe objeteve të tjera komunale, largimi i kafshëve të ngordhura nga sipërfaqja publike dhe ndërmarrja e masave të tjera të rregullta dhe të jashtëzakonshme, me qëllim të mirëmbajtjes të pastërtisë dhe higjienës publike.

Veprimtari komunale, përkatësisht punë konform dispozitave të kësaj Rregulloreje konsiderojmë: furnizimi i vendbanimeve me ujë, bartja dhe pastrimi i ujërave të përgjithshme, bartja e ujërave atmosferike nga sipërfaqet publike, pastrimi i sipërfaqeve publike, bartja, deponimi dhe përpunimi i hedhurinave dhe mbeturinave, rregullimi dhe mirëmbajtja e sipërfaqeve gjelbëruese, mirëmbajtja e varrezave, e tregjeve, larja dhe spërkatja e rrugëve, si dhe ndriçimi publik i rrugëve.



Sipërfaqe publike, konform dispozitave të kësaj Rregulloreje, konsiderojmë sipërfaqe me të cilat lejohet kalimi i numrit të pacaktuar të personave, siç janë: sipërfaqet e trafikut publik ( rrugët tjera të trafikut publik: stacioni i autobusve pompat e benzinës, hapësirat e parkingut, tregjet, trotuaret, rrugët, sheshet, sipërfaqet publike të gjelbëruara: parqet, sipërfaqet me bar, lumenjtë, sipërfaqet për pushim dhe rekreacion, terrenet argëtuese dhe sportive, kinematë dhe sallat të tjera që shërbejnë për tatimet publike të njerëzve, rrugët dhe varrezat.

Hapësirat të tjera, konform dispozitave të kësaj Rregulloreje, konsiderohen ato hapësira që nuk janë publike, por që shërbejnë për nevojat e ndërmarrjeve, organeve, grupeve të qytetarëve dhe personave të caktuar.

Gropat septike, në kuptim të kësaj Rregulloreje konsiderohen: gropat për ujësjellës, kanalizim, rrejt elektrik, telefonik dhe telegrafik e të ngjashme.

## **II.GROPAT SEPTIKE, KANALIZIMI DHE GROPIMI I RRUGËVE**

### **Neni 3.**

Në vendbanimet ku nuk është i ndërtuar rrjeti i kanalizimit duhet të ndërtohen nevojtoret higjienike të fushës, të cilat duhet të jenë të ndërtuara nga materiali i fortë dhe me gropë septike, e cila duhet të jetë së paku 30 metra larg objekteve të ujit – puseve dhe 20 metra nga objektet banesore të afërta.

Pastrimi me kohë të nevojtoreve edhe gropave septike sipas kërkesës së shfrytëzuesit të shërbimeve e kryen Ndërmarrja komunale për mirëmbajtjen e pastërtisë, ndërsa për mirëmbajtjen e gropave kujdesen ndërmarrjet, organizatat institucionet dhe personat tjerë juridikë, të cilët i shfrytëzojnë këto gropa, përkatësisht pronarët e ndërtesave.

### **Neni 4.**

Gropimi i sipërfaqeve publike mund të bëhet për vendosjen e instalimeve nëntokësore dhe mbitokësore dhe i objekteve, ose për mirëmbajtjen dhe rikonstruimin e tyre, vetëm nëse për vendosjen dhe rikonstruimin e tyre nuk mund të bëhet shpuarja. Lejen për gropimin e sipërfaqeve publike (trotuarit dhe rrugës), në të cilën caktohen: kushtet e kryerjes së punëve, mënyra e sigurimit të kalimtarëve dhe automjeteve, koha brenda së cilës duhet të kryhen punët dhe mënyra e sipërfaqeve publike pas punëve të kryera, e lëshon organi Komunal i Administratës për Çështje të Ndërtimit.

Punët e gropimit e sipërfaqeve publike janë punë urgjente dhe duhet të kryhen brenda afatit dhe kushteve të caktuara në leje, ndërsa kryerësi i punëve ka për detyrë që para gropimit të sipërfaqeve publike të sigurojë vendpunimin sipas lejes së lëshuar. Pas kryerjes së punës në sipërfaqet publike, kryerësi i punëve ka për detyrë që sipërfaqen

publike ta rregullojë, siç ka qenë më parë dhe ta mirëmbajë 5 muaj nga dita e kryerjes së punëve. Ndërkaq, nëse investitori dhe kryerësi i punëve pas kryerjes së punëve nuk e rregullon sipërfaqen publike, siç ka qenë më parë, organi i Administratës Komunale, i cili ka lëshuar lejen për kryerjen e punëve mundet me vendim të vet të urdhërojë, që ta bëjë ndërmarrja tjetër me shpenzime të investitorit të punëve.

Në qoftë se në rrjetin elektrik, të ujësjellësit, ose të kanalizimit shkaktohen prishje të cilat duhet të rregullohen menjëherë, për shkak të mundësisë së shkakimit të dëmeve edhe më të mëdha materiale apo paraqesin rrezik për jetën dhe shëndetin e njerzëve, ndërmarrjeve, ose të personave tjerë juridikë, të cilët mirëmbajnë këto instalime, mundet pa leje të gropohet sipërfaqja publike për rregullimin e prishjes në instalimin në fjalë, nëse leja për shkaqe objektive nuk mund të merret menjëherë.

Ndërmarrjet, personat tjerë juridikë, të cilët gropojnë, ose prishin sipërfaqet publike për rregullimin e prishjeve duhet menjëherë pas rrethanave objektive e më së largu brenda afatit prej 3 ditësh t'i drejtohen organit kompetent komunal të ndërtimit për marrjen e më vonshme të pëlqimit për kryerjen e punëve dhe caktimin e mënyrës së rregullimit të sipërfaqeve publike.

Në qoftë se organizata, apo personi fizik gjatë gërmimit të sipërfaqeve publike dëmton instalimet elektriket, telefonike të ujësjellësit, kanalizimit, është i obliguar që në afatin prej 48 orësh ta merremetojë, ( të kthejë instalimet në gjendjen e mëparshme )

Në qoftë se defekti nuk kthehet në afatin e caktuar, inspektori do të urdhërojë një kryerësi të punëve tjetër në llogari të dëmtuesit dhe do të ngrisë fletëparaqitjen për kundërvajtje.

### III. UJËSJELLËSI

#### Neni 5.

Ndërmarrja Komunale Publike, e cila i kryen punët ujësjellësit ka për detyrë që konsumatorëve t'ju sigurojë sasi të mjaftueshme të ujit higjienik.

Detyrimi i furnizimit mund të ndërprehet në rast të pengesave të befasishme me reparte dhe teknikë të shkaktuara pa fajin e tyre e shkaktuar nga fuqia madhore, ndërprerjes së furnizimit të repartit me energji elektrike dhe me punët e rregullta dhe të jashtëzakonshme me meremetimin e pajisjeve, ndërsa ndërmarrja komunale, të cilës janë besuar punët e ujësjellësit dhe kanalizimit e ka për detyrë që përmes mjeteve të informimit publik t'i njoftojë shfrytëzuesit e vet për shkaqet dhe zgjatjen e ndërprerjes, si dhe me shkrim inspektorin sanitar.

Ndërkaq, në qoftë se bëhet planifikimi paraprak i ndërprerjes lokale të furnizimit me ujë, ndërmarrja komunale e ka për detyrë që së paku 48 orë përpara t'i njoftojë shfrytëzuesit me ndërprerjen e planifikuar të ujit, nëpërmes mjeteve të informimit publik dhe inspektorët sanitarë.



#### IV. KYÇJA NË UJËSJELLËS DHE KANALIZIM

##### Neni 6.

Leje për kyçjen në rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit sipas kërkesës së investuesit e lëshon organi kompetent komunal me pëlqimin e Ndërmarrjes Komunale, të cilës janë besuar këto punë duke iu përmbytur dispozitave sanitare – teknike për vendosje në rrjetin e ujësjellësit dhe të kanalizimit dhe është përgjegjëse për cilësinë e të gjitha llojeve të punëve rreth kyçjeve.

Kyçja në ujësjellësin publik, shfrytëzimi dhe matja e ujit të shfrytëzuar duhet të bëhet vetëm përmes ujëmatësit. Nëse prishet ujëmatësi, Ndërmarrja Komunale do të caktojë shumën paushalle të pagimit në bazë të mesatares tremujore të ujit të konsumuar derisa ka punuar ujëmatësi e deri në momentin e rregullimit të ujëmatësit.

##### Neni 7.

Vënia, meremetimi dhe ndërimi i ujëmatësit dhe shpenzimet e pronarit, përkatësisht të shfrytëzuesit bëhet vetëm nga ana e Ndërmarrjes Komunale brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e paraqitjes së kërkesës së pronarit, përkatësisht të shfrytëzuesit. Shpenzimet e ndërtimit të kyçjes dhe shpenzimet të tjera të lidhjeve, të kyçjes së përsëritur i kompenzon pronari, përkatësisht shfrytëzuesi sipas tarifës së lejuar të Kuvendit të Komunës.

Të gjitha defektet e ujësjellësit dhe kanalizimit të rrjetit të qytetit Ndërmarrja për Mirëmbajtje duhet t'i evitohet më së largu në afat prej 48 orësh.

Të gjitha prishjet dhe dëmtimet në rrjetin e ujësjellësit, të ujëmatësit dhe të armaturës së tij, konsumatori ka për detyrë ta evitohet brenda afatit prej 24 orësh. Ndërmarrja Komunale ka të drejtë ta mbyllë ujin në ujëmatës në këto raste:

- kur nuk paguhet uji i shpenzuar,
- kur konsumatori paraqet shpërnguljen, ndërsa konsumatori i ri nuk e paraqet ujin e shpenzuar,
- kur meremetimi, pengesat dhe dëmtimet bëhen në rrjetin e ujëmatësit,
- kur instalimi i ujësjellësit i dëmton shfrytëzuesit e vet, përkatësisht cilësia e ujit në rrjetin e ujësjellësit nuk është i mirë,
- nëse gropa e ujit është e ndotur, e mbyllur, ose e prishur, ndërsa konsumatorit edhe pse i është bërë vërejtja me shkrim nga organizata, nuk ka ndërmarrë veprime për meremetim, brenda 15 ditësh pas njoftimit,
- në raste kur llogoria për ujin e shpenzuar nuk paguhet brenda afatit prej 8 ditësh pas marrjes së vërejtjes me shkrim,
- rregullimi vënia i ujëmatësit nga personi i paautorizuar

##### Neni 8.

Ndërmarrja Komunale e ka për detyrë të pengojë çdo derdhje të ujit, ndërsa konsumatorët e kanë për detyrë t'iu përmbahen udhëzimeve të marra. Ndërmarrja Komunale me qëllim të pengimit të çdo derdhje të ujit duhet të ndërmarrë këto masa:

- nëse shpenzohet shumë ujë, posaçërisht gjatë verës, është e autorizuar të kontrollojë instalimet e ujësjellësit të konsumatorëve dhe të kontrollojë ujin e shpenzuar,
- në rast thatësie dhe vështirësive të tjera në furnizimin e qytetit me ujë të pijshëm, ndërmerr masa teknike për kufizimin e shenzimit të ujit. Në këto raste Ndërmarrja Komunale i propozon Bordit Ekzekutiv të Kuvendit të Komunës që me urdhërin e vet të caktojë mënyrën e shpenzimit të ujit, të kufizojë ose të ndalojë shpenzimet e ujit për të gjitha llojet e caktuara të konsumit, si dhe mënyrën e kontrollimit të kufizimeve të caktuara dhe zbatimit të saj, ndërsa konsumatorët e kanë për detyrë t'iu përmbahen udhëzimeve të marra.

#### Neni 9.

Mirëmbajtja – (rikonstruimi), vendosja e rrjetit elektrik telefonik shenjave të trafikut, kanalizimit të ujërave atmosferike, të zeza dhe trotuarit investon Komuna. Ndërsa, për mirëmbajtjen e rregullt të ndriçimit, shenjave të trafikut, kanalizimit të ujërave të zeza dhe atmosferike, pastrimi i borës gjatë dimrit, larja e rrugëve, pastrimi dhe grumbullimi – transporti i mbeturinave bie në kompetencë të ndërmarrjes që merret me shërbimet publike në territorin e komunës së Klinës.

#### Neni 10.

Ndërmarrja për shërbime publike ka për obligim që të pastrojë dhe grumbulloi ( transportoi ) mbeturinat e rrugëve dhe trotuarit në tërë qytetin e Klinës.

Vendi i deponisë së mbeturinave është në vendin e quajtur Sferkë e Thatë.

Pastrimi i rrugëve duhet të bëhet sipas mënyrës dhe kohës e cila siguron efikasitet më të mirë të pastrimit dhe, që në masë ma të vogël pengon kalimtarët dhe rrjedhen e trafikut.

Ndalohet pastrimi dhe larja e rrugëve në kohën prej orës 7:00 e deri në ora 23:00, në përjashtim të kushteve dhe nevojës së jashtëzakonshme, poashtu, edhe spërkatja prej orës 7:00 deri në ora 19:00.

#### Neni 11.

Të gjitha rrugët e qytetit duhet të jenë të ndriçuara natën me ndriçim përkatës. Shtyllat e ndriçimit publik duhet të jenë stabile dhe në pozitë vertikale në mënyrë që të mos cenojnë sigurinë e mjedisit, respektivisht kalimtarët dhe trafikun. Poashtu, shtyllat duhen të jenë të mbrojtura si duhet nga aspekti i elektrocitetit.



#### Neni 12.

Gërmimi ( gropimi ) i sipërfaqeve publike e rrugëve - trotuareve mund të bëhen për vendosjen e instalimeve nëntokësore, vetëm në qoftë se konstatohet se nuk mund të bëhet shpuarja ( nën shtresen e rrugës ).

Gërmimi mund të bëhet vetëm pasi të sigurohet leja paraprake nga organi përkatës i Kuvendit Komunal të Klinës.

Lejen për gërmimin ( mihjen ) e rrugës e vendosjen e instalimeve, apo mirëmbajtjen e tyre e jep organi i Administratës, përkatësisht Departamenti për Urbanizëm Veprimtari Komunale dhe Banesore.

Në leje caktohen kushtet e kryerjes së punëve, mënyra e sigurimit të automjeteve dhe kalimtarëve, koha brenda të cilës duhet të kryhen punët. Poashtu, në leje caktohet kthimi i sipërfaqës publike ( rrugës ) në gjendje të mëparshme dhe mirëmbajtja e saj në kohëzgjatje prej 5 muajsh.

#### Neni 13.

Në qoftë se gjatë mihjes, apo gropimit, dëmtohen instalimet nëntokësore kryerësi i punëve është i obliguar që instalimet ( rrjetin e dëmtuar ) ta rregullojë menjëherë në afat më së voni prej 48 orësh.

Në qoftë se kryerësi i punëve ( dëmtuesi ) s'e menjanon prishjen në afatin e caktuar inspektori komunal me aktvendim cakton një kryerës tjetër në shpenzime të dëmtuesit të mëparshëm dhe të njejtit t'i ngritet fletëparaqitja për kundërvajtje.

### **V. MBAJTJA E PASTËRTISË DHE HIGJENËS KOMUNALE NË SIPËRFAQE DHE OBJEKTE**

#### Neni 14.

Për mirëmbajtjen e rrugëve me kanalizim dhe pa kanalizim mbi të cilat zhvillohet trafiku publik të cilat shërbejnë për përdorim të përgjithshëm, kujdeset Ndërmarja e autorizuar për mirëmbajtjen e pastërtisë dhe higjienës publike që i ka marrë këto punë përsipër.

Për mirëmbajtjen e pastërtisë dhe higjienës publike në trotuar para ndërtesave të banimit, afariste dhe ndihmëse, trojeve të pandërtuara dhe hapësirave rreth objekteve, në të cilat kryhet veprimtaria e përhershme ose e përkohëshme, kujdesen pronarët, përkatësisht shfrytëzuesit e atyre sipërfaqeve dhe objekteve.

Në rrugë dhe në vendet tjera publike, letrat dhe mbeturinat e tjera hudhen vetëm në enët e destinuar për këtë qëllim, të cilat i sigurojnë shfrytëzuesit e atyre sipërfaqeve.

#### Neni 15.

Për pastrimin e borës nga trotuaret para ndërtesave afariste, banesave kolektive kujdesen personat juridikë, të cilët i shfrytëzojnë ndërtesat afariste, ndërsa për pastrimin e borës nga trotuaret para ndërtesave banesore familjare dhe lokaleve, kujdesen pronarët dhe shfrytëzuesit e banesave kolektive dhe hapësirave afariste. Ndërmarrjet dhe qytetarët e kanë për detyrë që, me rastin e pastrimit të sipërfaqeve, ta grumbullojnë borën dhe akullin në skajin e trotuarit, ndërsa Ndërmarrja Komunale ta largojë borën nga skaji i trotuarit jashtë qytetit menjëherë, por më së largu në afat prej 12 orësh nga dita e marrjes së urdhërit nga organi kompetent.

#### Neni 16.

Mirëmbajtja e rrugëve të qytetit të Klinës konform dispozitave të kësaj Rregulloreje, nënkuptohet mirëmbajtja, rikonstruktimi, ndriçimi, vendosja e kanalizimit të ujërave të zeza, ujërave atmosferike, shenjave të trafikut, kabllove telefonike dhe elektrike, pastrimi grumbullimi dhe transporti i mbeturinave, larja dhe spërkatja e rrugëve.

#### Neni 17.

Për mbajtjen e pastërtisë dhe të higjienës komunale në hapësirat e parkingut, tregjeve, stacioneve të autobusve, sipërfaqet e gjelbëruara, terrenet e arkëtimit, kujdeset Ndërmarrja Komunale dhe atë:

- Ndërmarrja Komunale ka për detyrë që në të gjitha tregjet të sigurojë sasi të mjaftueshme të ujit higjienik të pijshëm, për freskimin e perimeve dhe pastrimin e tregut, si dhe të ndërtojë numër të nevojshme të nevojtoreve me numër të nevojshëm të kabinave, të cilat të pastrohen dhe të mirëmbahen si duhet dhe të vëhen enë të mjaftueshme për mbeturina dhe bërllok (kova dhe kontinierë), të cilat duhet të mbahen dhe të pastrohen rregullisht. Çdo ditë pas kalimit të orarit të punës tregjet duhet të pastrohen dhe të sjellen në gjendje të rregullt,
- për mirëmbajtjen e pastërtisë në parqe, në vende me bar dhe sipërfaqe tjera të gjelbëruara, të cilat gjenden në oborre, ose midis ndërtesave banesore, afariste dhe administrative, si dhe të objekteve tjera, janë përgjegjës pronarët, përkatësisht shfrytëzuesit e këtyre objekteve në të cilat gjenden këto sipërfaqe të gjelbëruara,
- për mirëmbajtjen e pastërtisë në Stacionin e Autobusve dhe në pompa të benzinës janë përgjegjëse ndërmarrjet, të cilat gëzojnë të drejtën e shfrytëzimit të këtyre objekteve,
- organet dhe organizatat të cilat qeverisin terrenet sportive dhe argëtuese kanë për detyrë të kujdesen për pastërtinë dhe higjienën komunale të këtyre terreneve.

#### Neni 18.



Heqja dhe deponimi i bërllogut shtëpiak, mbeturinat dhe bërlloku nga sipërfaqet publike si dhe largimi i fekaleve bëhet nga ndërmarrja komunale "Ujëvara" dhe, atë si vijon:

- Ndërmarrja Komunale ka për detyrë që rregullisht dhe si duhet të pastrojë enët e bërllokut ( kovat, kontinieret dhe pjesët tjera) dhe duhet të ketë kujdes atë më rastin e largimit të bërllokut shtëpiak dhe mbeturinave në oborret e ndërtesave dhe sipërfaqeve publike të mos shkapërderdhen mbeturinat dhe bërlloku,
- ndërmarrjet, organizatat, institucionet dhe personat të tjerë juridikë, si dhe qytetarët kanë për detyrë që të sigurojnë enët përkatëse për grumbullimin e mbeturinave, ndërsa vendosja dhe shpërndarja e enëve të tipizuara për mbeturina ( kontinierëve) bëhet nga Ndërmarrja Komunale,
- Ndërmarrja Komunale ka për detyrë që bërllokun shtëpiak dhe mbeturinat nga shfrytëzuesit e shërbimeve t'i largojë së paku 3 herë në javë në kohë të caktuar bërllokun dhe mbeturinat e rrugës çdo ditë pas pastrimit, bërllokun nga shitoret dhe dyqanet zejtere 3 herë në javë dhe jashtëzakonisht sipas nevojës, ndërsa bërllokun dhe mbeturinat industriale sipas nevojës, organi kompetent i Administratës Komunale mundet në rastet e jashtëzakonshme kohore dhe për shkaqe të tjera të arsyeshme të caktojë që në pjesët e caktuara të qytetit, bërllogu dhe mbeturinat shtëpiake të largohen shumëherë,
- Ndërmarrja Komunale nuk do t'i kryejë shërbimet e largimit të mbeturinave ndërmarrjeve shoqërore, private dhe publike, institucioneve, enteve, shitoreve private që nuk janë të pajisura me mjetet përkatëse për vendosjen e mbeturinave,
- largimi i bërllokut shtëpiak, fekaleve dhe ujërave të ndotura nga nevojtoret e fushës dhe gropat septike, mund të bëhet vetëm me mjete të destinuara dhe të pajisura për këtë qëllim për të mos u shkakuar shkapërderdhja e bërllokut dhe e mbeturinave, si dhe derdhja e fekaleve dhe ujërave të tjera të ndotura në sipërfaqet publike,
- Ndërmarrja Komunale ka për detyrë që organeve të inspektionit kompetent komunal dhe inspektionit të rrugëve publike më së largu deri në 15 të muajit ta paraqes planin e pastrimit dhe të larjes së sipërfaqeve publike dhe planin e largimit të bërllokut shtëpiak dhe mbeturinave për muajn e ardhshëm në verifikim.

Neni 19.

Mirëmbajtjen e tregjeve duhet ta bëjë ndërmarrja e autorizuar për shërbime publike "Ujëvara" në Klinë, ndërsa vlera e çmimit për kryerjen e kësaj pune caktohet me vendim të veçantë të Kuvendit Komunal.

## **VI. MINIMUMI I KUSHTEVE PËR MIRËMBAJTJEN E PASTËRTISË NË FSHATRA**

Neni 20.

Të gjithë qytetarët, pronarët e ndërtesave banesore, si dhe pronarët e lokaleve të punës, janë të detyruar që të mbajnë higjienën rreth objekteve të tyre, rrugëve publike dhe objekteve të ujit.

Organet e bashkësisë lokale në fshatra mund të kërkojnë nga pronari, që në afat të caktuar të pastrojë sipërfaqen rreth objektit të vet, si dhe rregullisht ta mirëmbajë.

Nëse shfrytëzuesi i objektit nuk vepron sipas intervenimit të atyre organeve në fshat, ato do të kërkojnë intervenimin e inspektorit sanitar dhe komunal.

Neni 21.

Pronarët e lokaleve banesore dhe afariste dhe objekteve duhet të kenë të ndërtuara nevojtoret sipas dispozitave higjieno – sanitare, larg objekteve të ujit (puset dhe burimet) më së paku 30 metra, varësisht nga konfiguracioni i terrenit, ndërsa nga ndërtesa tjetër e burimit dhe rruga më së paku 20 metra.

## **VII. MIRËMBAJTJA E BRIGJEVE DHE SHTRETËRVE TË LUMENJVE**

Neni 22.

Për mirëmbajtjen e pastërtisë dhe higjienës komunale – tokës pranë lumenjve dhe brigjeve të tjera në territorin e komunës së Klinës, kujdeset Ndërmarrja Komunale që i është besuar mirëmbajtja e higjienës dhe shërbimi për mirëmbajtjen e ambientit, si dhe pronarët që i posedojnë tokat pran lumenjve.

Për mbrojtjen e ambientit në tërësi kujdeset inspeksioni përkatës në kuadër të Drejtorisë kompetente, i cili ndërmerr masat përkatëse ligjore në rastet e shfrytëzimit kundërlogjor të rërës, zhavorit në shtretërit e lumenjve dhe në afërsi të tyre.

Neni 23.

Shtretërit e lumenjve dhe brigjet duhet të mirëmbahen në gjendje të rregullt dhe të pastër, si dhe së paku një herë në vit duhet të rregullohen dhe pastrohen.

Për pastrimin dhe rregullimin e brigjeve, shtretërve të lumenjve, të tokave pran lumenjve kujdeset Drejtoria për Bujqësi Zhvillim Rural dhe ambient, si dhe Ndërmarrja Komunale e autorizuar për mirëmbajtjen e pastërtisë, dhe qytetarët që jetojnë përreth lumenjve dhe që posedojnë toka dhe shtëpi.



## **Ndalesat**

### **Neni 24.**

1.Hedhja e mbeturinave, kafshëve të ngordhura, shpezëve të ngordhura në tokat pranë brigjeve shtretërve të lumenjve,

2.Hudhja dhe lëshuarja e fekaleve, ujërave industriale të kanalizimit nga industria,

3.Hudhja e mbeturinave, ambalazhit,automjeteve të avarisura , të vjetra, materjale ndërtimore, orendive të vjetra shtëpiake, vajrave dhe yndyrave të ndryshme, si dhe çfardo mbeturinash,

4.Prerja dhe dëmtimi i drunjëve rreth brigjeve pa lejen e organit të administratës,

5.Eksploatimi i zhavorit natyrorë, rërës, në shtretërit, brigjet e lumenjëve dhe vendet tjera si dhe transportimi i të njejtit material pastaj dheut, gurve dhe materjaleve të tjera të gurit si dhe burimeve tjera të mineraleve, pa lejen përkatëse të organit kompetent komunal,apo të dokumentacionit tjetër të rregullt respektiv të fletngarkimit apo të transportimit.

## **VIII. NJËSI PUNUESE E ELEKTRODISTRIBUIMIT NË KLINË**

### **Neni 25.**

Njësia punuese e elektrodistribuimit në Klinë, e cila i kryen punët e shërbimeve publike rreth sigurisë dhe shpërndarjes së energjisë elektrike i nënshtrohet rregullave përkatëse të kësaj Rregulloreje.

Kujdeset lidhur me sigurimin e ndriçimit publik të rrugëve, parqeve dhe hapsirave tjera publike si dhe mirëmbajtjen e tij.

### **Neni 26.**

NP-e nga al.1 e nenit 25 kujdeset për sigurimin e energjisë elektrike, mirëmbajtjen e rrjetit elektrik, si dhe furnizimin e qytetarëve me energji elektrike.

### **Neni 27.**

Për shkeljen e dispozitave të kësaj Rregulloreje nga ana e personave fizikë si dhe nga përsonat tjerë juridik që veprojnë në territorin e komunës së Klinës,do të pasojnë masat ndëshkimore kundervajtse dhe tjera ligjore.

## **IX. NJISIJA PUNUESE E PTK-së NË KLINË**

### **Neni 28.**

Njisija punuese e PTK-së në Klinë,e cila i kryen punet e shërbimeve publike rrethë:sigurimit dhe mirëmbajtjes se rrjetit telefonik,evitimin e defekteve të shkaktuara në rrjet,si dhe punë tjera profesionale rrethë kësaj lëmije i nënshtrohet dispozitave përkatëse të parapara më këtë rregullore.

Neni 29.

Kujdeset rreth shpërndarjes së numrave të telefonisë fikse dhe asaj mobile për komunën e Klinës.

Neni 30.

Për shkeljen e dispozitave të kësaj Rregulloreje i nënshtrohet masave sanksionuese, si edhe personat tjerë juridikë që veprojnë në territorin e komunës së Klinës.

## **X .TARIFAT RRETH SHFRYTËZIMIT TË UJIT**

Neni 31 .

Shpenzimi i ujit paguhet sipas tarifës 1 m<sup>3</sup>, ndërsa sasia e ujit të shpenzuar caktohet nga ujëmatësi, ndërsa çmimi për 1m<sup>3</sup> caktohet me vendim të veçantë të Kuvendit Komunal.

Nëse shumë banues, përkatësisht shfrytëzues e shfrytëzojnë ujin vetëm nga një ujëmarrës, shërbimi për ujin e shfrytëzuar do të llogaritet sipas numrit të anëtarëve të familjeve, ndërsa në objektet banesore të reja ku ndërtohen shumë banesa, investitori e ka për detyrë të sigurojë ujëmatës për çdo banesë.

Neni 32.

Kanalizimin publik e mirëmban dhe e pastron Ndërmarrja Komunale. Shpenzimet rreth mirëmbajtjes të kanalizimit shtëpiak i paguan ndërmarrja, pronari ose shfrytëzuesi i objektit, nëse prishja shkaktohet me fajin e shfrytëzuesit të objekteve.

Shpenzimet e mirëmbajtjes të kanalizimit publik paguhen sipas tarifës e miraton Ndërmarrja Komunale me pëlqimin e Kuvendit të Komunës.

## **XI. NDALESAT**

Neni 33.

Me qëllim të mbajtjes së pastërtisë dhe higjienes komunale, ndalohet :

1. Hudhja e letrave, mbështjellsëve, gazetave të vjetra, kartuçeve, xhamit dhe ambalazhit metalik, si dhe të mbeturinave tjera jashtë kovave për mbeturina, ose krijimi i pa pastërtisë në ndonjë mënyrë tjetër në sipërfaqe publike,
2. Hudhja e kafshëve dhe shpezëve të ngordhura dhe i mbeturinave të tjera nga kafshët dhe shpezët e therura në trotuar, rrugë, oborre të afërta dhe sipërfaqe tjera publik,
3. Çdo lëshim dhe derdhje e fekaleve nga nevojtoret dhe derdhja e ujërave të ndotura dhe papastërtisë në trotuarë, rrugë, oborr dhe sipërfaqet e tjera publike, ose hudhja



- në këto sipërfaqe të tyre apo bartja e bërrllokut, dheut, materjalit ndezës, ndërtimor dhe materjalit tjetër,
4. Largimi i bërrllokut mbeturinave dhe fekaleve me mjetet që nuk janë të destinuara për këtë veprimtari.
  5. Mbajtja e bërrllokut dhe mbeturinave në enët të cilat nuk i plotsojnë kushtet e përcaktuara,
  6. Ndotja e fasadave vitrinave dhe pjesëve tjera të jashtme të ndërtesave dhe të hapsirave të tjera punuese,
  7. Larja e veturave të udhëtarve dhe automjeteve bartëse në trotuar dhe rrugë,
  8. Shfrytëzimi i sipërfaqeve publike para lokaleve personale afariste ( trotuarit dhe rrugës ) për ekspozimin dhe shitjen e mallarave dhe të gjërave ushqimore, ose me qëllim të vendosjes së mallit ambalazhit, lëndëve dhe pjesëve të tjera,
  9. Shfrytëzimi i sipërfaqeve të trafikut publikë në kundërshtim në destinimin e tyre apo dëmtimi i tyre nëp qfardo mënyre,
  10. Gropimi i sipërfaqeve publike ( trotuari dhe rrugës ) për çfardo qëllimi, pa marrjen paraprake të lejes nga organi kompetent i administratës,
  11. Kryerja e veprimtarisë zejtare në sipërfaqe publike – shoqërore, trotuar dhe në rrugë,
  12. Sharritja dhe coptimi i druve, coptimi i thëngjillit, shkapërderdhja e vajit dhe materjalit tjetër në trotuar dhe rrugë,
  13. Shkapërderdhja e armaturës nëpër sipërfaqe publike ( trotuar dhe rrugë ) dhe lidhja e armaturës në shtylla elektrike te drurit etj.,
  14. Largimi i enëve për mbeturina nga vendet e caktuara,
  15. Transportimi i materjalit ndërtimor shkapërderdhës dhe materjali tjetër me automjete që nuk janë të destinuara për këtë transport,
  16. Hudhja e pajisjeve shtëpiake të vjetra, mbeturinave industriale dhe materjalit tjetër, si dhe mallit në hapsirat e lira publike,
  17. Vendosja e përzirësve të betonit për përzirjen e betonit në trotuar dhe rrugë dhe vendosja e materjalit ndërtimor,
  18. Lënia e automjeteve të havarisura, të vjetra, ose të pa përdorshme në sipërfaqet e trafikut, trotuarë dhe rrugë.
  19. Lëshuarja e ujjit në rrugë apo trotuar nga lokalet afariste pa marrë parasysh se çfarë është uji i pastër apo i papastër,
  20. Vendosja e reklamave dhe shenjave tjera në sipërfaqet publike pran rrugës pa siguruar lejen paraprake nga organi përkatës kompetent,
  21. Vendosja e kiosqeve mbi shaktat e ujësjellësit dhe kanalizimit,
  22. Parkingu i automjeteve mbi shakta – puseta,
  23. Kycja në rrjetin e ujësjellësit apo kanalizimit pa e siguruar lejen nga organi përkatës i administratës,
  24. Dalja në rrugë – sipërfaqe publike me automjet apo makina bujqësore nga toka bujqësore pa i pastruar ato nga balta,
  25. Lëshuarja dhe kullotja e bagtive në sipërfaqe publike jashtë vendit të destinuar për këtë qëllim.

#### Neni 34.

Në sipërfaqet publike ndalohet:

1. Lëvizja jashtë rrugëve dhe stazeve të caktuara,
2. Lëshimi i kafshëve dhe shpezëve,
3. Prerja dhe thyerja e paautorizuar e drunjve dhe luleve,
4. Dëmtimi i kovave për mbeturina,
5. Ndezja e zjarrit jashtë vendeve të caktuara,
6. Hudhja e kafshëve dhe shpezeve të ngordhura,
7. Hudhja apo lëshuarja e ujërave fekale apo industriale,
8. Dëmtimi i shtyllave të ndriçimit publik, thyerja dhe heqja e poçave, dëmtimi i shenjave të trafikut
9. Vendosja në sipërfaqet e trafikut publik të enëve për bërlllok ( kova , kontenjerë e të ngjashme ),
10. Hudhja e zjarrit, ndezja e mbeturinave dhe bërlllokut tjetër në enët për mbeturina në oborret e ndërtesave kolektive dhe sipërfaqet tjera të trafikut publik,
11. Zbrazja dhe lënia e mbeturinave jashtë vendit të caktuar për këtë qëllim dhe të materialit ndërtimor, dheut, rërës, zhavorit dhe materialit tjetër.

#### Neni 35.

Me qëllim të mbajtjes së pastërtisë në fshatra, ndalohet :

1. Derdhja dhe shkapërderdhja në këto sipërfaqe e fekaleve të nevojtove, të ujërave të ndotur,
2. Shpërndarja e plehut të kafshëve, sanës dhe materialit tjetër gjatë transportimit,
3. Hudhja dhe lënia e kafshëve dhe shpezëve të ngordhura në sipërfaqe,
4. Hudhja e mbeturinave, letrave dhe të bërlllokut tjetër nga ndërtesat dhe oborret e veta,
5. Ndezja e bërlllokut, gomave dhe materialit tjetër, që e bëjnë të ndotur ambientin dhe kushtet e jetës.

#### Neni 36.

Me qëllim të shfrytëzimit të drejtë të rrjetit të ujësjellësit dhe të kanalizimit, ndalohet :

1. Në kanalin shtëpiak dhe të oborrit lëshimi dhe hudhja e bërlllokut, hirit, çimentos, leckave, rërës dhe mbeturinave tjera të ngjashme, të cilat mund të shkaktojnë prishjen dhe dëmtojnë funksionimin normal të pajisjeve të ujësjellësit dhe të kanalizimit,
2. Në rrjedhat e rrugëve të hudhen lëndë të forta dhe material tjetër,



3. Në kanalizim të hudhen mbeturina nga pastrimi i rrugëve, oborreve dhe tregjeve,
4. Hudhja në kanalet e ujit dhe të tjera të materialeve ose mbeturinave të dëmshme:
5. Lëshimi në kanale pa leje e Ndërmarrjes Komunale të ujërave të ndotur të organizatave zejtare dhe industriale,
6. Hudhja në kanale të materjaleve ndezëse, të cilat mund të shkaktojnë zjarr,
7. Çfarëdo prishjesh të tjera në objektet e ujësjellsit dhe kanalizimit: si pusetat, kapakët etj.

## **XII. MASAT NDËSHKUESE - GJOBAT**

### **Neni 37.**

Me gjobë prej 500 DM gjer më 2000 DM do të gjobitet për kundërvajtje përsonat juridikë, nëse veprojnë në kundërshtim me nenet 6, 7, 12, 13, 15, 17, 18, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 30, 33, 34, 35, dhe 36 të kësaj Rregulloreje.

Me gjobë prej 50 DM gjer me 200 DM do të gjobitet për kundërvajtje përsonat fizik - qytetarët nëse veprojnë në kundërshtim me nenet 6, 8, 12, 13, 15, 22, 23, 24, 25, 26, 33, 34, 35 dhe 36 të kësaj Rregulloreje.

Me gjobë prej 5 DM gjerë me 20 DM, do të gjobitet në vend(gjobë mandatore), qytetari nëse benë ndonji nga kundërvajtjet nga nenet 33,34,35 dhe 36 të kësaj Rregulloreje.

Për kundërvajtje që bëjnë të miturin do të gjobiten prindërit apo kujdestari, i cili kujdeset për të.

Pagesa e gjobave bëhet me valutën përkatëse që aplikohet si mjet pagese në Kosovë.

## **X. DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT**

### **Neni 38**

Për zbatimin e kësaj Rregulloreje kundeset Drejtoria për Urbanizëm dhe Shërbime Publike, si dhe ndërmarrja komunale për shërbime publike "Ujëvara" në Klinë.

### **Neni 39.**

Masat e kontrollit dhe inspektimit përkatës si dhe gjobat aplikohen nga inspektoret kompetent komunal, nën mbikqyrjen e Kryeshefit Ekzekutiv .

Neni 40.

Për të gjitha çështjet të cilat nuk janë të përfshira në këtë Rregullore vlejnë drejtëpërsëdrejti dispozitat përkatëse ligjore pozitive nga lëmia e shërbimeve publike dhe rendit komunal.

Neni 41.

Ndryshimi dhe plotësimi i kësaj Rregulloreje do të bëhet në procedurë të njejtë si për miratimin e saj.

Neni 42.

Kjo Rregullore hyn në fuqi nga dita e miratimit nga Kuvendit të Komunës.

Nr. 237/2001  
Klinë, më 10.10. 2001

KUVENDI KOMUNAL



Kryetari,  
Ramë Manaj